- E) Të përfitojë me regjistrim, blerje ose në një mënyrë tjetër, dhe të pranojë, marrë, zotërojë, tregtojë, konvertojë dhe shesë aksione të çdo natyre, kapital (stock), obligacione ose letra të tjera me vlerë ose interesat e ndonjë shoqërie, organizate apo biznesi.
- F) Të japë kredi dhe t'i japë hua ose paradhënie monetare çdo personi, shtëpie apo kompanie, për të garantuar dhe dhënë garanci dhe dëmshpërblime apo sigurime (indemnities) për pagesën e parave ose përmbushjen e kontratave ose detyrimeve nga çdo personi, shtëpie apo kompanie, për të siguruar e marrë përsipër në çdo mënyrë shlyerjen e parave që i janë dhënë ose është dhënë hua financiare ndonjë personi, shtëpie ose shoqërie ose detyrimet që bien mbi këtë person apo kompani, dhe të ndihmojë me mënyrë tjetër personin apo shoqërinë me mënyrën që kompania do ta konsideronte të duhurën.
- (50) Financimi, huadhënia ose dhënia e kredive ose asistencës tjetër financiare ose ofrimin e ndihmës ose shërbimeve për të siguruar financim, huazim ose dhënie të kredive ose ndihma të tjera për personat të lidhur ose që kanë të bëjnë me Shoqërinë ose persona të tjerë.
- (51) Sigurimi i garancive dhe dokumenteve të dëmshpërblimit në lidhje me detyrimet dhe/ose kontratat dhe/ose huatë e çdo personi, kompanie, shtëpie apo organizatat që janë të varura ose të lidhura me Kompaninë ose klientët e Kompanisë ose çdo person tjetër fizik ose juridik, shtëpi ose organizata të palëve të treta.
- (52) Blerja apo përfitimi i të gjithë ose një pjese të biznesit, pasurisë dhe detyrimeve të çdo shoqërie, organizate, shtëpie apo personi, qëllimet e të cilit përputhen tërësisht ose pjesërisht me qëllimet e Kompanisë, ose të secilit prej tyre dhe kryerja, likuidimi ose shkrirja e ndonjë biznesi të tillë.
- (53) Themelimi, përfitimi, menaxhimi dhe ndihma, pjesëmarrja ose kujdesi direkt ose indirekt në themelimin, blerjen, drejtimin ose kryerjen e çdo angazhimi, akti apo biznesi të çfarëdo natyre dhe kryerja e çdo tregtie, pune ose biznesi që mund të kryhet në mënyrë fitimprurëse nga Kompania në lidhje ose paralelisht me secilin nga qëllimet, aktivitetet ose punët e përgjithshme të Kompanisë.
- (54) Pagesa e parave ose sendeve të tjera për blerjen e të drejtave ose pasurive dhe dhënia e shpërblimit për çdo person qoftë me para në dorë ose duke emetuar aksionet e saj ose letra të tjera me vlerë të Kompanisë si të shlyera plotësisht ose pjesërisht ose me mënyrë tjetër.

(55) Investimi i fondeve në dispozicion të Shoqërisë dhe për këtë qëllim blerja, ruajtja, shkëmbimi, përdorimi i aksioneve, obligacioneve apo letrave me vlerë të tjera të çdo natyre tjetër të interesave të të drejtave ose një prone të luajtshme ose të paluajtshme.

(56) Pagesa e abonimeve ose kontributeve për bamirësi apo qëllime të tjera të dobishme, publike, forcimi i të cilave mund, sipas gjykimit të Kompanisë, të kontribuojë në rritjen e reputacionit apo popullaritetit të Kompanisë midis stafit të saj, klientëve ose audiencës.

(57) (a) Përfundimi, sigurimi ose dhënia e kredive ose fondeve të tjera, lehtësira ose detyrime financiare ose kreditore (ose nga shoqëri ose person tjetër fizik ose juridik) me ose pa sigurim në atë mënyrë që Kompania do të konsiderojë të drejtë hipotekën, pengun ose barrën e të tërës ose të ndonjë pjese të biznesit dhe të tërë asetëve dhe pasurive të luajtshme ose të paluajtshme të kësaj Shoqërie apo të ardhshme, duke përfshirë kapitalin e quajtur të Shoqërisë ose të ndonjë pjese të saj, për sigurimin e ndonjë kredie ose lehtësie apo detyrimet (qoftë se i përkisni një shoqërie tjetër si person fizik apo juridik) si dhe lëshimin e kambialeve, tarifave, obligacioneve, kambialeve, letrave me vlerë, borxhit, obligacioneve me tarifa të luhatshme (FLOATING CHARGE) ose jo dhe bondeve debitore (DEBENTURES) të paguara në çdo kohë dhe në çdo mënyrë që mund të vendoset nga Kompania për arritjen e qëllimeve më të larta.

- b) Për të marrë hua, për të gjetur para ose për të siguruar detyrime (ose të Shoqërisë ose të një personi tjetër) në mënyrën dhe sipas kushteve që do ta gjykonte të përshtatshme dhe më konkretisht me emetimin e kambialeve (debentures and debenture stock) fuqia e të cilave është e vazhdueshme ose mund të ndërpritet me kambial, hipotekë ose çdo titull tjetër të krijuar ose të bazuar në të gjitha ose disa nga asetet dhe të drejtat e Kompanisë, duke përfshirë kapitalin e Kompanisë që nuk është thirrur për t'u paguar, ose pa ndonjë sigurim të tillë dhe me kushte të tilla, sa i përket përparësisë apo me mënyrë tjetër, të tilla si Shoqëria do të përcaktonte sipas gjykimit të saj, çdo herë.
- c) Të vazhdohet me emetimin e aksioneve, obligacioneve (debentures) ose letrave të tjera me vlerë të Shoqërisë, në emërimin e ndërmjetësve, përfaqësuesve me komision dhe personave, organizatave ose bankatve që sigurojnë asgjësimin e letrave me vlerë (underwriters) dhe të kujdeset për shpërblimin e tyre, për shërbimet e ofruara prej tyre me pagesë me para në dorë ose duke emetuar aksione, obligacione (debentures) ose letrave të tjera me vlerë të shoqërisë, ose duke dhënë një opion për marrjen e tyre ose në ndonjë mënyrë tjetër ligjore.
- d) Për të lëshuar ose garantuar emetimin ose pagesën e interesit të aksioneve, obligacioneve të borxhit (debentures and debenture stock) ose letra me vlerë ose detyrime të tjera të çdo shoqërie ose organizate dhe për të paguar ose rregulluar pagesën e ndërmjetësve, komisionet dhe shpenzimet për sigurimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të letrave me vlerë (underwriting), në lidhje me ndonjë publikim të tillë.

(58) (a) Pranimi i hipotekave, obligacioneve, barrave, lënien peng, pengut të aksioneve ose letrave të tjera me vlerë ose kolateral, dhe caktimin, transferimin, modifikimin, zëvendësimin ose lirimin e tyre duke siguruar detyrimet e Shoqërisë ose të një personi tjetër fizik ose juridik.

B) Sigurimi i çdo forme garancie ose mbulimi (Indemnity) në çfarëdo mënyre ndaj çdo personi fizik ose juridik dhe çdo favor në dobi të çdo personi fizik ose juridik dhe sigurimin e çdo shume të garantuar duke siguruar të njëjtat tarifa dhe/ose garanci sikur të ishte një kontratë hua nga Shoqëria dhe dhënia dhe marrja e kundërgarancive (Counter-guarantees) dhe garancitë e kryqëzuara (Cross-guarantees).

(59) Nënshkrimi, lëshimi, miratimi, caktimi, blerja, negociimi dhe parapagimi i obligacioneve të borxhit ose i obligacioneve aëo dokumentave të këmbimit, ngarkimit, tregtimit ose negociimit ose i transferimit, vlerave ose titujve si dhe çdo lloj fature tregtare ose dokumentet dhe në përgjithësi kryerja e veprimeve juridike të një natyre së ngjashme.

(60) Themelimi, promovimi ose pjesëmarrja në themelimin e ndonjë shoqërie dhe përfitimi me regjistrim, blerje apo mënyrë tjetër për pranimin, marrjen, posedimin, këmbimin, shitjen ose tjetërsimin e aksioneve, kapitalit, të parave, obligacioneve ose letrave të tjera me vlerë ose interesave të kujtdo kompanie, organizate ose biznesi.

(61) (a) Lëshimi dhe dhënia e shlyerjes plotësisht ose pjesërisht të aksioneve dhe të kapitalit të Shoqërisë për pagesën të çdo pasurie të luajtshme ose të paluajtshme të blerë ose me përvetësuar ndryshe nga Kompania ose ndonjë shërbim dhënë kompanisë dhe/ose në ndonjë mënyrë tjetër pagesa për çdo pronë ose shërbim të fituar dhënë në çfarëdo mënyre Shoqërisë.

(b) Të emetojë dhe japë aksione që janë shlyer ose që nuk janë shlyer nga kapitali i shoqërisë ose emetohen obligacione (debentures) ose letra me vlerë për pagesën e plotë ose të pjesshme, të çdo pasurie të luajtshme ose të paluajtshme të blerë ose të fituar në ndonjë mënyrë tjetër nga Shoqëria apo të çdo shërbimi të dhënë për Kompaninë dhe për pagesën në para ose në mënyrë tjetër të ndonjë personi, shtëpie ose kompanie për shërbimet e kryera prej shoqërisë ose për të dhënë donacione për këta persona.

(62) Lidhja e marrëveshjeve, kontratave dhe kryerja e çdo veprimi me çdo shtet, qeveritar, komunal, komunitet ose autoritet tjetër ose Organizata ose me ndonjë person që sipas rrethanave do të konsiderohet i nevojshëm apo ndihmues për realizimin e qëllimeve të Shoqërisë.

(63) Aplikimet dhe fillimi i procedurave dhe marrja, blerja ose me mënyrë tjetër përfitimi, dhënia me qira, shkëmbimi, regjistrimi dhe përdorimi i ndonjë patente, marke tregtare, licence, marke

komerciale, të drejtat e autorit, koncesionet, kompetencat ligjore, të drejtën ose privilegjin dhe shitjen nga Shoqëria, dhënien, dhurimin, dhënien me qira ose në ndonjë mënyrë tjetër asgjësimin ose sigurimin ose dhënien e licencave ose pëlqimit për përdorimin e tyre.

(64) Bashkimi, partneriteti, ndarja e fitimit, bashkimii me çdo mënyrë, bashkëekzistenca, marrëveshja financiare ose bashkëpunimi me çdo person fizik ose juridik, i cili ka veprimtarinë e tij ose në Qipro ose jashtë vendit dhe kryen ose angazhohet ose interesohet të kryejë ose angazhohet në ndonjë biznes, punë, veprimtari ose akt që Shoqëria ka të drejtë të kryejë ose mundet sipas mendimit të Këshilltarëve të kryejë paralelisht me punët e Kompanisë ose me një mënyrë që i shërben direkt ose indirekt qëllimeve të Shoqërisë.

(65) (a) Shpërndarja tek anëtarët në natyrë të çdo pasurie të Shoqërisë ose të produktit të shitjes ose disponimin e përgjithshëm të një prone të tillë me kusht që, nese kjo shperndarje rezulton me pakesimin e Kapitalit, kjo do të bëhet vetëm në mënyrën që ka qenë prej kohësh koha e përcaktuar me ligj.

(b) Për të shitur, disponuar, hipotekuar, ngarkuar, siguruar të drejtat ose privilegjet (rights or options) ose për të transferuar operacionet, asetet dhe bizneset e Kompanisë ose ndonjë pjesë e tyre kundër çdo konsiderate që kompania do të pranonte sipas gjykimit të saj.

(c) Të pranojë kapital (stock) ose aksione ose obligacione (debentures), obligacione të garantuara me hipotekë (mortgage debentures) ose letra të tjera me vlerë të çdo shoqërie tjetër për pagesën e plotë ose të pjesëshme, çdo shërbimi që i ofrohet ose shitja e bërë nga kjo Shoqëri nga çdo borxh që ka të bëjë me shoqëri tjetër të ngjashme.

(d) Për të shpërndarë në natyrë (in specie) ose para ose në një mënyrë tjetër, si do të vendosej çdo herë, çdo aset të saj të kapitalit aktiv që Shoqëria ka, midis anëtarëve të saj, dhe më konkretisht aksionet, obligacione (debentures) ose letra me vlerë të ndonjë kompanie tjetër që i përket kësaj kompanie ose për të cilat kompania mund të disponojë.

(e) Për të kryer të gjitha ose disa nga operacionet e lejuara nga Ky Dokument Themelues në çdo vend të botës e vetme ose së bashku me kompani, shtëpi ose persona të tjerë, qoftë si agjent, komisioner, principal, nënkontraktor ose përfaqësues të kompanive të tjera, shtëpive ose personave, ose nëpërmjet agjentëve, komisionerëve, nënkontraktorëve ose përfaqësuesve.

(66) Pagesa e të gjitha shpenzimeve, tarifave dhe shpenzimeve që kanë të bëjnë me promovimin dhe themelimin e Kompanisë ose që Kompania e konsideron të jetë Kosto fillestare duke përfshirë kostot, studimet dhe këshillat, printim, artikuj shkrimi dhe kosto të ngjashme.

(67) Themelimi, pjesëmarrja, sponsorizimi dhe ruajtja ose kontributi në themelimin dhe mirëmbajtjen e çdo Fondi Pensioni, Përkrahjeje apo përfitimeve të tjera, me ose pa kontribute ose për mbështetje ose shërbim të çdo personi që është ose ka qenë në çdo kohë në shërbim të Shoqërisë ose çdo shoqërie tjetër që ndodh të jetë i varur ose miqësor ose i lidhur ndryshe me Kompaninë ose të personave që kanë qenë këshilltarë ose zyrtarë të Shoqërisë ose të një shoqërie tjetër të lidhur ose të varur ose të bashkëshortët, vejushëve, familjeve ose personave të tjerë të varur ose të cilitdo

prej këtyre personave dhe pagesën ose ndryshe kontributin për ofrimin ndaj personave të tillë, të donacioneve, bakshisheve, pensioneve, granteve, kontributeve apo ndihmave të tjera.

(68) Regjistrimi ose njohja e Shoqërisë në çdo vend tjetër dhe pajtueshmëria me çdo kusht në mënyrë që Kompania të mund të kryejë punë dhe për të krijuar në këto ambiente zyra, filiale ose përfaqësi për të arritur qëllimet e Kompanisë.

(69) Kryerja e të gjitha ose ndonjë prej profesioneve, bizneseve të mësipërme, veprimeve ose bizneseve në çdo vend të botës, qoftë nga Kompania, duke vepruar në emër dhe për llogari të saj ose duke vepruar si përfaqësues, ndërmjetës, kontraktor, agjent ose ndryshe, dhe /ose vetëm ose bashkërisht me të tjerët dhe drejtpërdrejt ose tërthorazi agjentë, nënkontraktorë, agjentë ose në ndonjë mënyrë tjetër.

(70) Miratimi, njohja, ratifikimi ose zbatimi i ndonjë prej kontratave, akteve ose akteve juridike të bëra në emër ose nga pjesë e Shoqërisë përpara regjistrimit të saj, pa asnjë modifikim siç do të gjykojnë drejt këshilltarët.

(71) Ndërmarrja dhe kryerja e ndonjë pune, akti ose veprimtari e cila sipas mendimit të Bordit të Administrimit mund të kryhet në mënyrë të favorshme, komode ose paralelisht me ndonjë prej qëllimeve dhe punëve të Kompanisë ose për të rritur drejtpërdrejt ose tërthorazi vlerën, shfrytëzimin ose efikasitetin e secilit prej bizneseve, punëve, asetëve fikse ose të drejtave të Kompanisë.

(72) Kryerja e çdo veprimi në përgjithësi që do të gjykohet i dobishëm, ndihmës, instrumental ose i favorshëm për arritjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të qëllimeve të mësipërme ose të ndonjë prej tyre.

(73) Të procedojë me çdo veprim, që do të kontribuojë ose do të jetë i nevojshëm për suksesin e qëllimeve të mësipërme ose të secilit prej tyre veçmas.

Do të thotë se:

(a) Është deklaruar shprehimisht se çdo paragraf i tij Neni 3 i Ligjit për shoqëritë tregtare, kreu 113, më sipër do të interpretohet në mënyrë të pavarur nga çdo pjesë tjetër e këtij paragrafi dhe se asnjë nga qëllimet e përmendura në ndonjë nga paragrafët e mësipërm do të konsiderohet si thjesht plotësues i qëllimeve të përmendura në ndonjë nga paragrafët e mësipërm.

(B) Pavarësisht këtij Akti Themelimi, asnjë ndryshim i këtij neni lidhur me përcaktimin e qëllimeve të Kompanisë do të marrë udhë pa miratimet paraprake të Autoriteteve Qeveritare kompetente.

Dhe me këtë deklarohet se në interpretimin e këtij paragrafi kompetencat të cilat i jepen Shoqërisë nga çdo nënparagraf i këtij paragrafi, nuk do të kufizohen ose ndikohen në çfarëdo mënyre nga ndonjë tjetër nënparagraf apo nga emri i Kompanisë dhe secili nga nënparagrafët më sipër do të interpretohet veçmas sikur të përmbajnë secilin prej tyre qëllimet kryesore të Kompanisë.

SIDA FOÇI
PËRKTHYES ZYRTAR
Επίσημος μεταφραστής
Cel: 069 21 43 777

Dhe po ashtu deklarohet se në këtë paragraf fjala "KOMPANI" aty ku nuk i referohet së njëjtës Kompani, do të konsiderohet se përfshin ndonjë shoqëri ose trupë personash me përgjegjësi të kufizuar ose jo, ose ndonjë person tjetër juridik, qoftë ajo e vendosur në Qipro ose jashtë saj dhe nëse është krijuar në përputhje me Ligjet e Qipros apo të ndonjë shteti tjetër. Fjala 'person' (me përjashtim të raseve që rezultojnë ndryshe nga teksti) do të konsiderohet se përfshin një person juridik.

4. Përgjegjësia e anëtarëve është e kufizuar.

5. Kapitali aksionar i Shoqërisë është 1,000.00 Euro (Një mijë Euro) i ndarë në 1000 aksione nga 1 Euro secila dhe me të drejte të Shoqërisë për rritje ose zvogëlim të këtij kapitali dhe me fuqinë për të emetuar aksionet e kapitalit, fillestar ose të rritur, me çdo preferencë, veçanërisht me të drejta ose kushte të specifikuar, kufizuese ose shtyrëse në lidhje me dividendët, shlyerjen e kapitalit, të drejtën e votës, pjesëmarrjen në tepricë ose të drejta dhe kushte të tjera.

Ne, të nënshkruarit, emrat dhe adresat e të cilëve janë më poshtë, dëshirojmë të themelojmë një kompani në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe ne pranojmë të marrim numrin e aksioneve që korrespondojnë me kapitalin e Kompanisë që shënohet përbri emrave tanë.

Emrat, Adresat dhe Përshkrimet e Firmëtarëve	Numri i aksioneve që ka marrë çdo Firmëtar
Eleftherios Karnachoritis Nr. Pasaportës: AMO222678 Shtetësia: Greke Levadeias 17, 16561, Glyfada Attiki, Greqi Sipërmarrës	(Një mijë aksione) 1000 X firmë

U nënshkrua më 3 Prill 2018

Dëshmitar i firmave të mësipërme
Olga Orati
Agion Omologiton 15,
1080 Nikosia, Qipro
Firmë

Kopje e njesuar me origjinalin
Georgios Triftarides
22/09/2022

ISIDA FOCI
PERKTHYES ZYRTAR
Επιτοπιος μεταφραστής
Cel: 069 21 43 781

APOSTIL

(Bazuar në Konventën e Hagës së 5 Tetorit 1961)

1. Vendi: **QIPRO**

Ky dokument publik

2. Është firmosur nga: **Georgios Triftarides**

3. Që ka vepruar në cilësinë e **Regjistruës Kompanish**

4. Mban vulën zyrtare të **Departamenti i Regjistrimit të Kompanive dhe Pronës Intelektuale, Ministria e Energjisë, Tregtisë dhe Industrisë**

Vërtetimi jepet

5. Në **APOSTILLE-MJPO**

6. Në datë **23/09/2022**

7. Nga **Constandinos Kokkinis**

8. Me numër **NIC MJPO-NIC 000516143/2022**

9. Vulë zyrtare

10. Firmë **Sekretari i Ministrisë së Drejtësisë dhe Rendit Publik**
92651589
firmë/vulë

ΕΙΔΙΑ ΦΟΪ
ΠΕΡΚΤΗΥΕΣ ΖΥΡΤΑΡ
Επιτοπος μεταρραατής
Cef : 069 23 43 233

LIGJI PËR SHOQËRITË KREU 113

**SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
NËPËRMJET AKSIONEVE**



**STATUTI
I
KOMPANISË**

**ELE.M.I.S CONSTRUCTIONS LTD
PARAPRAK DHE INTERPRETIMI**

1. Kompania është një kompani private dhe si më poshtë vijon:
 - (a) E drejta për të transferuar aksione është e kufizuar sipas mënyrë së caktuar në vijim.
 - (b) Numri i anëtarëve të kompanisë (duke përjashtuar personat që janë në shërbimin e shoqërisë dhe personave që kanë shërbyer më parë në shërbimin e shoqërisë dhe kanë vazhduar pas përfundimit të punësimit të tyre që të jenë anëtarë të shoqërisë), kufizohet në pesëdhjetë.
Me kusht që kur dy ose më shumë persona zotërojnë bashkërisht një ose më shumë aksione do të konsiderohen si një anëtar.
 - (c) Çdo ftesë për Publikun për t'u abonuar për aksione ose obligacione të shoqërisë është e ndaluar.
 - (d) Shoqëria nuk ka autoritet për të lëshuar urdhra për aksione ndaj bartësit.
2. (a) Në varësi të asaj që parashikohet më poshtë, Rregulloret e përfshira në Pjesën 1 të tabelës "A" të Buletimit të Parë të Ligjit për shoqëritë tregtare, Kreu 113, përveç rregulloreve 24, 25, 53, 60, 62, 75, 79, 82, 89 deri në 94, 98, 99, 106 dhe 113 (Rregullore të cilat në vijim do të referohen si "Tabela A") do të zbatohen në Shoqëri, por për rastet e ndryshimit, konfliktit apo mosbindjes mes këtyre Rregulloreve dhe Tabelës A, këto Rregullore do të mbizotërojnë.
- (b) (1) Kompania mund të regjistrohet ose mund të funksionojë si një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar me një anëtar të vetëm. Në një rast të tillë rregulloret e përfshira në

Pjesën I të Tabelës "A" të Buletinit të Parë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Kreu 113, me përjashtim të rregulloreve 24, 25, 53, 60, 62, 15, 79, 52, 86 deri 94, 98, 99, 111 (a), 112, 106 dhe 113 do të zbatohen për Shoqërinë, por në rastet e ndryshimit, konfliktit apo mospërputhjes ndërmjet të këtyre rregulloreve dhe tabelës A, (me përjashtim të Rregulloreve 24, 53, 111 (a) dhe 112) këto rregullore do të mbizotërojnë.

(2) Përderisa Shoqëria ka një anëtar të vetëm, miratohet Pjesa 3 e Tabelës A së Shtojcës së Parë të Ligji për Kompanitë, Kreu 113:

(a) anëtari i vetëm i Shoqërisë ushtron të gjitha kompetencat e asamblesë së përgjithshme, në bazë të Ligjit, kuptohet gjithmonë që vendimet që do të merren nga ky anëtar në asamblatë e përgjithshme do të regjistrohen në procesverbal ose do të hartohen me shkrim.

(b) kontratat, të cilat janë lidhur ndërmjet të vetmit anëtar dhe Shoqërisë, regjistrohen në procesverbal ose hartohen me shkrim, përveç rasteve kur kanë të bëjnë me transaksionet aktuale të Shoqërisë lidhur në rrethana normale.

3. (a) Në Rregulloren I të Tabelës A ndërmjet fjalës 'rregullore' (rreshti i parë) dhe fjalëve "Ligji" (rreshti i dytë), përfshihen fjalët "dhe çdo rregullore që ndryshon ose miraton ato".


(b) Përveç nëse në tekst rezulton ndryshe, fjalët ose shprehjet të përfshira në këtë Statut do të kenë të njëjtin kuptim si tek Ligji ose tek ndonjë ndryshim në fuqi në datën kur ky Statut bëhet i detyrueshëm për Shoqërinë.

KAPITALI AKSIONAR DHE TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

- Shoqëria mundet herë pas here me vendim të veçantë të rrisë kapitalin aksionar me një shumë të tillë të ndarë në aksione me vlerë të tillë që mund t'u lëshohet personave të tillë dhe në kushte të tilla që do të parashikohen në vendim.
- Aksionet që do të emetohen nga kapitali fillestar ose çdo kapital i rritur i Kompanisë, përveç pas një vendimi të veçantë të Kompanisë, do të ofrohet fillimisht anëtarëve në raportin sa më të afërt me vlerën nominale të aksioneve të mbajtura prej tyre. Çdo ofertë e tillë do të jetë e hapur për pranim për të paktën gjashtë javë nga data e dërgimit të saj. Çdo aksion që nuk pranohet brenda periudhës kohore së mësipërme, do të jetë në dispozicion të Këshilltarëve të cilët do të mund ta pranojnë, japin të drejtën e votës ose në një mënyrë tjetër të disponojnë tek këta persona, në këto momente dhe në kushte të tilla që do e konsiderojnë të saktë.
- (a) Duke respektuar dispozitat e këtij Statuti aksionet do të janë në dispozicion të Këshilltarëve që kanë të drejtë lëshimi, dhënie, shpërndarje ose përgjithësisht vënien e tyre në dispozicion të çdo personi në çdo kohë me ose të drejtat preferenciale, të veçanta, të specifikuar ose të shtyrjes në lidhje me dividendët, shlyerjen e kapitalit, të drejtat e votës, pjesëmarrja me tepricë dhe me çdo kusht tjetër dhe parakusht që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

(b) Në përputhje me dispozitat e nenit 112 të Ligjit dhe të këtij statuti, Shoqëria, me vendim të Këshilltarëve, mund nëse e dëshiron, dhe nëse kjo i komunikohet me shkrim, të njohë ekzistencën e një trusti (trust) në çdo aksion edhe pse nuk mund ta regjistrojë këtë në Regjistrin e anëtarëve të Shoqërisë. Kjo njohje nga Shoqëria i bëhet e ditur përfaqësuesve (trustees) me letër dhe është i parevokueshëm, përderisa ky besimit vijon të ekzistojë, edhe nëse përfaqësuesit ose disa nga ata donin të zëvendësoheshin.

(c) Kompania pranon marrjen dhe mbajtjen e aksioneve nga aksionarët nominalë (nominees) për llogari të përfituesve (beneficiaries) të cilët (aksionarët nominalë) do të mbajnë aksionet në besim (in trust) për të mirën e përfituesve. Aksionarët nominalë do të kenë të drejtë të ushtrojnë në emër të tyre të gjitha të drejtat e parashikuara për anëtarët nga këto rregullore.



BLERJA E ASKIONEVE

7. Në përputhje me dispozitat e ligjit, shoqëria mund të blejë apo përvetësojë aksionet e veta drejtpërdrejt ose nëpërmjet një personi që vepron në emër të tij, por për llogari të saj.

E DREJTA E MBAJTJES

8. Në rregulloren 11 të tabelës A fjalët "(që nuk janë plotësisht aksion i paguar)" dhe "(përveç aksioneve që janë plotësisht paguar)" fshihen.

9. Sigurimi nga çdo anëtar i çdo aksioni është i ndaluar si peng ose garanci për të siguruar ndonjë hua, borxh ose detyrim pa pëlqimin paraprak me shkrim të Këshilltarëve dhe Këshilltarët kanë detyrimin të refuzojnë regjistrimin ose njohjen e një pengu ose sigurimi të dhënë në kundërshtim me këtë Rregullore, do të konsiderohet i pavlefshëm kundrejt Kompanisë.

THIRRJE PËR AKSIONE

10. Në Rregulloren 15 të Tabelës A fjalët "me kusht që asnjë thirrje nuk do të kalojë një të katërtën e vlerës nominale të aksionit ose do të jetë e paguar në më pak se një muaj nga dita e caktuar për pagesën e thirrjes menjëherë paraardhëse" do të hiqet.

TRANSFERIMI I AKSIONEVE

11. Këshilltarët mundën sipas gjykimit të tyre absolut dhe pa justifikuar vendimin e tyre për të refuzuar regjistrimin e transferimit të ndonjë aksioni nëse është paguar plotësisht ose jo në emër të personit që nuk është miratuar prej tyre. Ata gjithashtu mund të refuzojnë të regjistrojnë transferimin e çdo aksioni në të cilin Kompania ka të drejtën e mbajtjes ose transferimit që do të sillte rritjen e numrit të anëtarëve përtej asaj që lejohet nga Rregullorja 1.

ISIDA FOCI
PERKTHYES ZYRTAR
Entonnes uctaq-pootijs
Cel : 069 21 43 723

12. Rregulloret 22 dhe 23 të Tabelë A do të lexohen dhe zbatohen sipas dispozitave të Rregullores 13 të këtij Statuti.

13. (1). Për qëllime të kësaj Rregulloreje kur një person ka të drejtë të regjistrohet si aksionar i Shoqërisë atëherë ky person dhe jo pronari i saj i regjistruar, do të konsiderohet si anëtar i Kompanisë në lidhje me këtë aksion.

(2) Përveç siç parashikohet më poshtë, asnjë aksion nuk do të transferohet tek një jo anëtar pa shteruar të drejtat e preferencës (pre-emption rights) që jepen më poshtë.

(3) Çdo person që synon të transferojë ndonjë aksion (në vijim do të referohet si "i preferuari për transferim") duhet të japë njoftim me shkrim (në vijim do të referohet "njoftim transferimi") Kompanisë me qëllim për t'i transferuar ato. Njoftimi i transferimit duhet domosdoshmërisht të tregojë shumën që i preferuari për transferim përcakton si vlerë të drejtë, ky njoftim e bën Kompaninë përfaqësuese për shitjen e aksioneve për çdo anëtar të Shoqërisë (në vijim do të referohet si "anëtarët blerës") në vend të vlerës së përcaktuar në mënyrën e mësipërme, ose nëse blerja e anëtarëve e zgjedh këtë, në vend të vlerës së drejtë që do të donte të përcaktohej nga audituesi i Kompanisë (më tej i referuar si "Audit") sipas nënparagrafit të mëposhtëm (7). Njoftimi i transferimit kur jepet, nuk mund të revokohet, përveç se pas lejes paraprake të Këshilltarëve.

(4) Pasi të përcaktohet vlera e aksioneve të ofruara për shitje, si p.sh të parashikuara në këtë rregullore, Shoqëria do të ketë detyrimin të japë njoftim me shkrim për të gjithë anëtarët e saj në të cilin do të tregohet numri dhe vlera e atyre aksioneve që ofrohen për shitje. Ky njoftim duhet të përmbajë gjithashtu një ftesë të Shoqërisë për anëtarët brenda njëzet e tetë ditësh nga ky njoftim, deklarojnë me shkrim nëse duan të blejnë ndonjë nga aksionet e ofruara për shitje dhe në rast përgjigjeje pozitive, numri maksimal i aksioneve që duan të blejnë.

(5) Sapo skadon afati prej njëzet e tetë ditësh referuar më lart, Kompania do t'i ndajë aksionet e ofruara anëtarëve që kanë shprehur dëshirën për t'i blerë ato në përputhje me çfarë tu referua më sipër dhe në rast se këta anëtarë janë më shumë se një, do t'i shpërndajë sa më shumë që të jetë e mundur në proporcion me numrin e aksioneve që ata tashmë zotërojnë. Kuptohet që asnjë anëtar nuk do të jetë i detyruar të marrë më shumë aksione nga numri që ka përcaktuar.

(6) Pas shpërndarjes së aksioneve të Shoqërisë siç u përmend më lart, Kompania do të ketë detyrimin ta bëjë të ditur këtë fakt të preferuarit për transferim. Më pas ai do të ketë detyrimin pasi të paguhet vlera e drejtë që do të përcaktohet sipas paragrafi (3) ose (7) të kësaj Rregulloreje, të transferojë aksionet te anëtarët blerës.

(7) Në rast të një ndryshimi midis të preferuarit për transferim dhe anëtarëve që blejnë ose secilës prej tyre, lidhur me vlerën arsyeshme të çdo aksioni, Audituesi me kërkesën e cila do të paraqitet nga ndonjëra nga palët e interesuara, do të vërtetojë me shkrim shumën që sipas gjykimit të tij përbën vlerën e drejtë dhe një shumë që ai përcakton do të konsiderohet vlera e

drejtë e aksioneve. Audituesi në ushtrimin e këtij autoriteti do të konsiderohet se vepron si ekspert (expert) dhe jo si arbitër, dhe rrjedhimisht edhe Dispozitat e Ligjit për Arbitrazhin, Kreu 4, nuk do të zbatohen.

(8) Në rast se i preferuari për transferim nuk e bën transferimin e aksioneve, ka detyrim sipas dispozitave të mësipërme për të transferuar, Shoqëria do të vazhdojë me mbledhjen të çmimit të shitjes dhe regjistrimit në Regjistrin e Anëtarëve të emrave të anëtarëve blerës si përfitues të aksioneve. Shuma e çmimit që do të merret në këtë mënyrë, Kompania do ta mbajë si Komisioner (trustee) të të preferuarit për transferim dhe fatura e Kompanisë për marrjen e tij, do t'i përjashtojë plotësisht ato nga detyrimi i tyre për të paguar këtë çmim. Pas regjistrimit në Regjistrin e Anëtarëve të emrave të anëtarëve që kanë blerë aksione sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, asnjë dyshim nuk do të lejohet lidhur me vlefshmërinë e procesit nga cilindo person.

(9) Nëse nuk arrihet shitja e të gjitha aksioneve të ofruara për shitje nga i preferuari për transferim në mënyrën e parashikuar më sipër, i preferuari për transferim do të jetë në gjendje lirisht në çdo kohë brenda tre muajve nga skadimi i njoftimit njëzet e tetë ditësh, duke iu nënshtruar dispozitave të Rregullores 11 së mësipërme, për të shitur dhe transferuar ndonjë nga aksionet e pashpërndara për çdo person dhe për cilindo çmim.

14. Kufizimet e transferimit të përfshira në Rregulloren 13 nuk zbatohen, duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të këtyre rregulloreve, për transferim

(a) miraton me vendim unanim të këshilltarëve rezolutën e posaçme e kompanisë,

(b) nga një anëtar në bashkëshort, pasardhës ose vëlla ose

(c) nga një anëtar në një kompani në pronësi ose të kontrolluar efektivisht prej saj, në rastin e një anëtari që është person juridik në një kompani mëmë ose bijë të një anëtari të tillë.

15. Në varësi të dispozitave të këtij Statuti, asnjë transferim nuk regjistrohet, përveç nëse dhe vetëm pas dorëzimit të një dokumenti të vlefshëm transferimi i një lloji të zakonshëm ose lloji të përcaktuar nga Këshilltarët, i nënshkruar nga Tjetërsuesi dhe Transferuesi ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar si dhe nga çdo element tjetër që Këshilltarët do kërkojnë vërtetimin e të drejtës së transferimit të personit që do të transferojë aksionin.

16. Në Rregulloren 29 të Tabelës A ndërmjet fjalëve “përfaqësues ligjorë personalë” dhe “e të ndjerit” do të shtohen fjalët “ose nëse ku ka përfaqësues personalë ligjorë, trashëgimtarët”.

PROCEDURA NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME

17. Asnjë punë nuk do të bëhet në asnjë Asamble të Përgjithshme, përveçse nëse ka kuorumin kur kuvendi fillon punimet. Nëse parashikohet ndryshe në këtë Statut, çdo anëtar i pranishëm ose personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi që zotërojnë më shumë se gjysmën aksioneve të emetuara, do të përbëjnë kuorumin. Duke respektuar dispozitat e Ligjit vendimet dhe çështjet që dalin në Asamblenë e Përgjithshme do të vendosen me shumicë votash.

18. Në Rregulloren 58 të Tabelës A fjalët "të paktën tre anëtarë" në nënparagrafin (b) zëvendësohen me fjalët "çdo anëtar" dhe nënparagrafët (c) dhe (d) fshihen.

19. Duke respektuar çdo të drejtë ose kufizim bashkangjitur çdo klase ose klasave të aksioneve, secili anëtar i pranishëm personalisht ose me përfaqësues do të ketë, në rast votimi me ngritjen e dorës, një votë, dhe në rast votimi të fshehtë një votë për çdo aksion që zotëron.

20. Në përputhje me dispozitat e Ligjit, një rezolutë me shkrim e firmosur nga të gjithë anëtarët që gjatë kohës së dhënë kishin të drejtë të marrin njoftim dhe të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblatë e Përgjithshme ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar, do të jetë i vlefshëm dhe efektiv sikur të ishte marrë në një Asamble të Përgjithshme që ishte thirrur dhe konstituuar ligjërisht.

KËSHILLTARËT

21. Me përjashtim të rasteve që vendoset ndryshe nga Shoqëria në një Asamble të Përgjithshme, numri i Këshilltarëve nuk do të jetë më i madh se dhjetë.

22. Këshilltarët e parë të Shoqërisë do të emërohen nga firmëtarë Aktit të Themelimit ose shumicës së tyre dhe nuk do të jetë i nevojshëm të thërritet Asambleja e Përgjithshme për këtë qëllim.

PUSHTETE TË HUAZUARA KËSHILTARËVE

23. Konsulentët mund të lidhin dhe të marrin kredi financiare pa çdo kufizim në lidhje me shumën e huazuar ose të tjera kredi ose lehtësira financiare dhe të hipotekojnë ose ngarkojnë të gjithë ose një pjesë të sipërmarrjes, të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të Kompanisë, të kapitalit të tanishëm dhe të ardhshëm ose të ndonjë pjese të tyre dhe të emetojnë obligacione (debentures), obligacione me ngarkesë të luhatshme (floating debentures), obligacione të siguruara me hipotekë (mortgage debentures), tarifa fikse (fixed charges), kambialet, kambialet dhe letrat e tjera me vlerë që i janë paguar mbajtësit ose me mënyrë tjetër dhe nëse këto janë në përjetësi ose të shlyeshme ose të ripagueshme dhe drejtpërdrejt ose si garanci për çdo hua, përgjegjësi ose detyrim i Kompanisë ose e ndonjë pale të tretë. Këto obligacione (debentures), obligacione me ngarkesë të luhatshme (floating debentures), obligacione të siguruara me hipotekë (mortgage debentures), tarifa fikse (fixed charges), tituj obliacioesh (debentures stock), kartëmonedha ose letra të tjera me vlerë, mund të emetohen me zbritje (at a discount) mbi premiumin (at a premium) ose ndryshe dhe me fuqi të tilla që blerja (redemption), dorëzimi (surrender), emetimi i aksioneve ose ndryshe që Këshilltarët e gjykojnë të qëllimshëm ose korrekt.

ISIDA FOÇI
PËRKTHYES ZYRTAR
Απόστολος Μεταφραστής
Cel: 069 21 43733



PUSHTETE DHE DETYRAT TË KËSHILLTARËVE

24. Paragrafët (2) dhe (4) të Rregullores 84 të Tabelës A janë fshirë dhe nuk aplikohen në Kompani. Çdo Këshilltar ose kompani ose ortakëri Këshilltari i së cilës është aksioner, partner ose konsulent, mund të kontraktojë me Shoqërinë sikur të mos ishte Konsulent dhe për të korrur çdo fitim ose përfitim që rrjedh nga një kontratë të tillë. Çdo këshilltar do të jetë në gjendje të votojë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një kontratë të tillë ose një marrëveshje tjetër pavarësisht nga fakti se ai mund të ketë ndonjë interes në këtë marrëveshje, si edhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me emërimin e tij me shpërblim në çdo pozicion ose detyrë në Kompani ose rregullimin e kushteve të këtij emërimi, me të drejtë të llogaritet në përcaktimin e kuorumit të Bordit të Administrimit në çdo seancë në të cilën do të diskutohet një çështje e tillë.
25. Për çdo këshilltar i cili, me kërkesë të Kompanisë ose të Bordit të Administrimit kryen shërbime të veçanta, profesionale ose të jashtëzakonshme për llogari të Kompanisë ose udhëton ose banon në çdo vend jashtë vendbanimit të tij të zakonshëm për të përmbushur detyrat e tij, mund t'i paguhet kompensim shtesë siç do të përcaktojnë Këshilltarët.
26. Këshilltarët kanë të drejtë të marrin pensione shërbimi, anuitete vjetore ose shpërblime ose subvencionime duke përfshirë dhe grantet e vdekjes, për çdo person ose vejtash ose persona në ngarkim të çdo personi për shërbime që ky person i ka dhënë Kompanisë nëse ka qenë CEO apo ka mbajtur një pozicion apo ka apsur angazhim tjetër në Kompani, nëse punonjësi ka qenë në mënyrë indirekte zyrtar apo punonjës i një filiali që kontrollohej nga kjo shoqëri, pavarësisht nëse ka qenë Këshilltar i Kompanisë, dhe Kompania mund të procedojë me pagesat për sigurime ose truste për qëllimet e mësipërme në lidhje me personin e mësipërm dhe mund të sigurojë ose të përfshijë të drejta në lidhje me këto pensione, anuitete vjetore dhe subvencione në terma punësimi të çdo personi të tillë.

RËNIA E KËSHILLTARËVE NGA POZICIONI DHE ALTERNIMI I KËSHILLTARËVE

27. Në Rregulloren 88 të Tabelës A nënparagrafët (a) dhe (f) do të hiqen.
28. Në rregulloren 95 të tabelës "A" fjalët "por nuk do të llogariten për caktimin e këshilltarëve që do të dalin në pension me zgjedhje me rotacion në këtë mbledhje" fshihen.


PROCEDURA E KËSHILLTARËVE

29. Këshilltarët mund të mblidhen për të kryer punën e tyre, për të shtyrë dhe rregulluar në përgjithësi punët e seancave të tyre ashtu siç do të gjykojnë drejtë. Çështjet e ngritura në seanca vendosen me shumicë votash. Çdo këshilltar ka të drejtë, dhe Sekretari me kërkesë të kujt do Këshilltari ka detyrimin të thërrasë mbledhjen e këshilltarëve. Njoftimi për seancë duhet t'u komunikohet të gjithë Këshilltarëve dhe Zëvendësve të tyre.

30. Numri i kërkuar i Këshilltarëve për të formuar kuorumin mund të përcaktohet me vendim unanim të tyre dhe deri në një përcaktim të tillë, një Këshilltar do të përbëjë kuorumin. Zëvendës Këshilltari do të përlogarisë për qëllime të kuorumit.

31. Mbledhjet e Këshilltarëve mund të thirren dhe zhvillohen ose në Qipro ose jashtë vendit dhe në atë vend dhe kohë që Këshilltarët do të vendosin.

32. Vendimi me shkrim i nënshkruar ose i miratuar me letër telegram, radiotelegرافي, fax, telefaks apo mjete të tjera të ngjashme nga të gjitha Këshilltarët ose zëvendësit e tyre do të jenë njëlloj të vlefshëm dhe efektiv, siç do të ishte nëse do të merrej në një mbledhje të këshilltarëve i cili ishte mbledhur dhe zhvilluar normalisht dhe kur të nënshkruhet mund përbëhet nga disa dokumente, secila prej tyre duhet të nënshkruhet nga një ose më shumë nga personat e lartpërmendur.



ZËVENDËS KËSHILLARËT

33. (1) Çdo këshilltar herë pas here mund të caktojë ndonjë Këshilltar ose person tjetër që do të veprojë si Zëvendës Këshilltar në çdo seancë apo seanca të Këshilltarëve dhe sipas gjykimit të tij ta revokojë një emërim të tillë. Emërimi ose revokimi i emërimit të Zëvendës Këshilltarit i bëhet Kompanisë me shkresë, telegram, telefax ose faks.

(2) Çdo Zëvendës Këshilltar u nënshtrohet në të gjitha aspektet të gjitha kushteve që vlejné për Këshilltarët (përveç të drejtës së emërimit të zëvendësit dhe pagesës) dhe ka të drejtë të marrë njoftimet e mbledhjeve të Këshillit dhe të jetë i pranishëm, të flasë edhe votojë në to. Zëvendës Këshilltari ka të drejtë për një votë shtesë për çdo Këshilltar në emër të të cilit vepron në mënyrë të pavarur dhe plus të vetën nëse është Këshilltar.

(3) Emërimi i Zëvendës Këshilltarit përfundon automatikisht në rast se Këshilltari që e ka emëruar pushon së kryeri detyrën e tij për çfarëdo arsye.

(4) Këshilltari i cili emëron Zëvendës Këshilltar nuk është përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e Zëvendës Këshilltarit që ai emëron.

CEO

34. Emërimi i një CEO do të kërkojë pëlqimin me shkrim të shumicës së aksionarëve dhe pa cenuar asnjë të drejtë, kjo do të konsiderohet si shkelje e çdo kontrate të lidhur, do të konsiderohet si e ndërprerë automatikisht nëse Këshilltari për ndonjë arsye, humbet statusin e Këshilltarit ose Kompania vendos me vendim të zakonshëm përfundimin e emërimit të tij.

35. Këshilltarët herë pas here mund të caktojnë dhe transferojné në CEO ndonjë nga kompetencat e tyre sipas kushteve të tilla, kushtet dhe kufizimet që ata do ta gjykojnë të drejtën për t'i vënë



për zbatim ose imponim dhe herë pas here të revokojnë ose modifikojnë autorizimet që kanë dhënë.

36. Këshilltarët herë pas here mund të emërojnë çdo person si Drejtor dhe t'i caktojnë, besojnë dhe transferojnë atij ndonjë nga kompetencat e tyre që i nënshtrohet kushteve dhe kufizimeve që ata do t'i gjykojnë të drejta ose të përshtatshme për t'i aplikuar ose imponuar dhe herë pas here të revokojnë ose modifikojnë këto kompetenca.

SEKRETARI

37. Sekretari emërohet nga Këshilltarët për aq kohë, me një shpërblim dhe kushte të tilla që Këshilltarët dëshirojnë të përcaktojnë sipas gjykimit të tyre dhe Sekretari i emëruar në mënyrën e mësipërme, mund të pushohet prej tyre.

38. Këshilltarët do të kenë autoritet në çdo kohë dhe herë pas here, do të emërojnë cilindo person si Ndihmës Sekretar ose Zëvendës Sekretar.

39. Dispozita e Ligjit ose e këtij Statuti i cili imponon ose autorizon të bëhet diçka nga apo në lidhje me një Këshilltar dhe Sekretarin, nuk do të konsiderohet se është realizuar, nëse këtë e ka bërë personi i cili njëkohësisht vepron dhe si Këshilltar dhe si ose në vend të Sekretarit. Kjo rregullore nuk zbatohet në rastin e shoqërisë me një anëtar të vetëm.

VULA

40. (a) Vula e Kompanisë do të përdoret vetëm pas autorizimit të Këshilltarëve dhe çdo dokument mbi të cilin vendoset vula duhet të nënshkruhet nga një Këshilltar ose Zëvendës Këshilltar ose Sekretari ose nga ndonjë person tjetër që ligjërisht është i autorizuar nga Këshilltarët. Vula e kompanisë mund të përdoret si më lart, nga personat e mësipërm, në Qipro ose jashtë tij.

(b) Kompania mund të ketë vulë zyrtare, përveç vulës së referuar më sipër, e cila do të jetë siç parashikohet në nenin 36 (1) të ligjit dhe mund të përdoret për synimet e përmendura në të.

NJOFTIMI

41. Në Rregulloren 134, paragrafi (a) fshihet dhe zëvendësohet si vijon: "(a) të gjithë anëtarët".

42. Çdo njoftim ose dokument mund të dorëzohet nga Kompania tek çdo anëtar ose personalisht ose duke e postuar në adresën e anëtarit siç figuron në Regjistrin e Anëtarëve ose në ndonjë tjetër adresë të dhënë nga anëtari për këtë qëllim. Njoftimet mund t'i dorëzohen çdo anëtari me letër, telefax, fax, telegram ose mjete të tjera të ngjashme në një numër të njoftuar nga anëtari dhe në këtë rast njoftimi do të konsiderohet se i është dorëzuar gjatë kohës së dërgimit të tij. Kur njoftimi është dërguar me postë, dorëzimi i njoftimit do të konsiderohet se është kryer me letër rekomande, që përmban njoftimin dhe që mban adresën e rregullt dhe taksat e rregullta

postale dhe se ka marrë udhë, në rastin e njoftimit të seancës, 24 orë pas dërgimit të letrës që përmban njoftimin dhe në çdo rast tjetër gjatë kohës që letra normalisht do të dorëzohej nga Posta.

DËMSHPËRBLIMI

43. Çdo Këshilltar ose zyrtar tjetër i Kompanisë do të ketë të drejtën e dëmshpërblimit nga pasuria e Kompanisë për çdo dëmtim ose përgjegjësi që ajo do të marrë në lidhje me kryerjen e detyrave të tij ose në lidhje me to, duke përfshirë çdo përgjegjësi për mbrojtjen e politikave ose procedimit penal gjatë të cilit është dhënë një vendim gjyqësor në favor të tij ose shpallet i pafajshëm në lidhje me çdo kërkesë sipas dispozitave të nenit 383 të Ligjit në të cilin i është dhënë nga Gjykata dhe asnjë Këshilltar apo zyrtar tjetër nuk do të ketë përgjegjësi për çdo dëm, humbje ose aksident që do të ndodhë në ose pësojë Kompania gjatë kryerjes së detyrave të tij ose në lidhje me to.

Emrat, Adresat dhe Përshkrimet e Firmëtarëve	Firma
Eleftherios Karnachoritis Nr. Pasaportës: AMO222678 Shtetësia: Greke Levadeias 17, 16561, Glyfada Attiki, Greqi Sipërmarrës	firmë

U nënshkrua më 3 Prill 2018

Dëshmitar i firmave të mësipërme
Olga Orati
Agion Omologiton 15,
1080 Nikosia, Qipro
Firmë

Vërtetoj se Akti i Themelimit të mësipërm dhe Statuti i Kompanisë u hartuan nga unë.
Michalis A. AEGYROY
Ushtrues i Profesionit të Avokatit
Zyra e Avokatisë
Angelides, Ioannides, Leonidou D.E.P.E.
Agion Omologiton 15,
1080 Nikosia, Qipro
Firmë

Kopje e njesuar me origjinalin
Georgios Triftarides
22/09/2022

ANIDA FOCI
PËRKTHYES ZYRTAR
Επισημώς μεταφραστὴς
Cel: 069 25 43 731

APOSTIL

(Bazuar në Konventën e Hagës së 5 Tetorit 1961)

1. Vendi: **QIPRO**

Ky dokument publik

2. Është firmosur nga: **Georgios Triftarides**

3. Që ka vepruar në cilësinë e **Regjistruës Kompanish**

4. Mban vulën zyrtare të **Departamenti i Regjistrimit të Kompanive dhe Pronës Intelektuale, Ministria e Energjisë, Tregtisë dhe Industrisë**

Vërtetimi jepet

5. Në **APOSTILLE-MJPO**

6. Në datë **23/09/2022**

7. Nga **Constandinos Kokkinis**

8. Me numër **NIC MJPO-NIC 000516142/2022**

9. Vulë zyrtare

10. Firmë **Sekretari i Ministrisë së Drejtësisë dhe Rendit Publik**
92651589
firmë/vulë

ISIDA FOÇI
PERKTHYES ZYRTAR
Επισημοσ ηεραρροορής
Cep: 069 21 43 722

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER VALBONA P. SINANI



V2022051460415879446

DATE 07/11/2022
NR REP 4789



VERTETIM PERKTHIMI

Sot në Tiranë, vërtetoj nënshkrimin e përkthyeses së njohur nga Ministria e Drejtësisë Znj. Isida Foci, atesia Ilirjan, mbajtese e Kartes së Identitetit nr 025469789 dhe numrin personal I15407219T, banuese në Tiranë, e cila deklaron se ka përkthyer saktësisht nga gjuha **Greke** në gjuhën **Shqipe** dokumentin të nënshkruar nga ajo, të bashkelidhur me origjinalin dhe unë, noteria e vërtetoj këtë praktikë, në përputhje me ligjin në fuqi



Ο ΠΕΡΙ ΕΤΑΙΡΕΙΩΝ ΝΟΜΟΣ ΚΕΦ. 113

ΠΕΡΙΟΡΙΣΜΕΝΗΣ ΕΥΘΥΝΗΣ ΔΙΑ ΜΕΤΟΧΩΝ

ΙΔΡΥΤΙΚΟ ΕΓΓΡΑΦΟ
(MEMORANDUM OF ASSOCIATION)

ΚΑΙ

ΚΑΤΑΣΤΑΤΙΚΟ
(ARTICLES OF ASSOCIATION)

ΤΗΣ

EL.EM.IS CONSTRUCTIONS LTD

Ιδρυθείσα την μέρα του μηνός του έτους 2018

Πιστοποιητικό ιδρύσεως αρ.

Υπεβλήθη υπό τη Δικηγορική Εταιρεία Αγγελίδης, Ιωαννίδης, Λεωνίδου Δ.Ε.Π.Ε.
Διεύθυνση: Αγίων Ομολογητών 15, 1080 Λευκωσία Τηλ. 22-452600

ΕΤΑΙΡΕΙΑ ΠΕΡΙΟΡΙΣΜΕΝΗΣ ΕΥΘΥΝΗΣ
ΔΙΑ ΜΕΤΟΧΩΝ

ΙΔΡΥΤΙΚΟΝ ΕΓΓΡΑΦΟΝ
(MEMORANDUM OF ASSOCIATION)

ΤΗΣ ΕΤΑΙΡΕΙΑΣ

EL.EM.IS CONSTRUCTIONS LTD

1. Η επωνυμία της Εταιρείας είναι: **EL.EM.IS CONSTRUCTIONS LTD**
2. Το εγγεγραμμένο Γραφείο της Εταιρείας θα βρίσκεται στην Κύπρο.
3. Οι σκοποί για τους οποίους ιδρύεται η Εταιρεία είναι:
 - (1) (α) Η εγκαθίδρυση και λειτουργία γραφείων στην Κύπρο ή στο εξωτερικό για τη διεύθυνση και διαχείριση εργασιών της εταιρείας.
 - (β) Η διεξαγωγή των εργασιών και επιχειρήσεων των εισαγωγέων, εξαγωγέων, εμπόρων, χονδρικής και λιανικής πώλησεως, διανομέων, παραγγελιοδόχων, μεταπωλητών, αντιπροσώπων, αντιπροσώπων με προμήθεια, μεσιτών, πρακτόρων, ανεφοδίαστων, αποθηκαρίων, διανομέων σε σχέση με οιασδήποτε εμπορεύματα, προϊόντα, εφόδια, αγαθά, πρώτες ύλες, ηλεκτρονικούς υπολογιστές, εκτυπωτές και όλα τα εξαρτήματα ή προσαρτήματα αυτών, τηλέτυπα, φωτοτυπίες, γραφομηχανές, προγράμματα, μηχανήματα, ηλεκτρικές συσκευές, οικιακά και ηλεκτρικά είδη, φαρμακευτικά υλικά και προϊόντα, δώρα, παιχνίδια, προμήθειες ή άλλα αντικείμενα προϊόντα ή εμπορεύματα οιασδήποτε φύσεως και περιγραφής.
 - (γ) Η διεξαγωγή εργασιών παροχής υπηρεσιών τηλεπικοινωνιών πάσης φύσεως, υπηρεσιών κινητής τηλεφωνίας ως και πάσης άλλης υπηρεσίας που αφορά υπηρεσίες που έχουν σχέση με τηλεπικοινωνίες.

- (δ) Η διεξαγωγή των εργασιών και επιχειρήσεων εταιρείας πληροφορικής και επικοινωνιών, η ετοιμασία, παραγωγή και διάθεση προγραμμάτων για ηλεκτρονικούς υπολογιστές και η παροχή υπηρεσιών και συμβουλών για οιονδήποτε θέμα που αφορά τεχνογνωσία ή τεχνολογία οιουδήποτε κλάδου ή επιχείρησης.
- (2) (α) Η διαπραγμάτευση, αγορά, πώληση, διαχείριση, αποθήκευση, εισαγωγή, εξαγωγή, επανεξαγωγή, διαφήμιση, διαμετακόμιση οιουδήποτε εμπορευμάτων, προϊόντων, υλικών, προμηθειών ή άλλων αντικειμένων πάσης φύσεως.
- (β) Η διεξαγωγή των εργασιών και δραστηριοτήτων των μεταφορέων διαβιβαστών, αποθηκαριών, φορτωτών, εργολάβων, διεκπεραιωτών, για τη μεταφορά εμπορευμάτων ή φορτίων παντός είδους και πάσης συναφούς, εμπορικής ή επιχειρησιακής πράξεως, εργασίας ή δραστηριότητας.
- (γ) Η διεξαγωγή των εργασιών και επιχειρήσεων των συμβούλων αναφορικά με οιονδήποτε θέμα ή κλάδο οιοσδήποτε επιχείρησης ή βιομηχανίας.
